



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 tetor 2018, në mbledhjen e pestë(5) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nënkryetari i Komunës z. Nexhmi Rudari.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, medieve lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë dhe z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: znj. Antigona Çitaku Dibrani, shefe e Sektorit të Operativës-Stacioni Policor Podujevë; Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri, Bekim Karaxhia-OSBE.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht ju uroj mirëseardhje, më lejoni të hapi mbledhjen. Para se të fillojmë me punë desha të ju informoj se është bërë një keqkuptim nga shërbimi administrativ me rastin e dërgimit të materialit për mbledhje, fjala është për pikën 4 të Rendit të ditës, dhe si rezultat i kësaj pasi që nuk kemi prezent Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe një zyrtar nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Rend i ditës

U miratua njëzëri me propozim të Kryetarit të Komunës që pika e 4 e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19 shtator 2018

U miratua njëzëri

2. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë
z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fillimisht fjalën e ka shefja Operative e Stacionit të Policisë znj. Antigona Çitaku Dibrani.

znj. Antigona Çitaku-Dibrani, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës vlerësohet e qetë dhe stabile. Kemi pasur një ngritje të lehtë të veprave penale të vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda ku gjatë këtij muaji kanë qenë gjithsejt 18 sosh, nga to janë zgjidhur 10 dhe 4 persona /kryers të këtyre veprave janë në vuajtje të denimit.

Nënvizoi, kemi në implementim e sipër Planet Operative:

Siguria në Komunikacion, plan i cili po mirepritet dhe është treguar i sukseshëm, ku target ka eliminim e parkingjeve të parregullta. Vetëm gjatë këtij muaji janë shqiptuar 404 gjoba në komunikacion dhe janë tërhequr 108 vetura të parkuara aty ku ndalohet me shenjë komunikacioni. Po ashtu kemi rënie të aksidenteve në komunikacion.

Plani nga Regjioni i Prishtinës "Masat e shtuara të sigurisë", është në implementim e sipër ku synim ka kontrollimin e personave dhe veturave që hasen në qarkullim në orët e vona.

Kemi pasur dy raste të grabitjeve, njëra tentim grabitje në terminalin doganor në Merdare dhe njëra grabitje në fshatin Shtedim ku nën kërcënimin e thikës një i dyshuar ka grabitur në një supermarket.

Të dy këto raste janë hetuar dhe janë identifikuar të dyshuarit, ku edhe janë në vuajtje të denimit.

Në rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve 4 personat e dyshuar janë dënuar me 8 muaj burgim. Gjatë këtij muaji kemi mbajtur ligjëratat në shkollat e Komunës së Podujevës, në ciklin e ulët dhe të mesëm, me temat: Siguri në komunikacion, dhuna në familje dhe pasojat nga përdorimi i narkotikëve. Këto ligjëratat janë mirëpritur nga personeli arsimor dhe nga nxënësit si dhe nga Këshilli i prindërve. Në të ardhmen do të vazhdohet persëri me tema që identifikohen nga ne që i kontribuojnë mirëqenjes dhe sigurisë së këtyre moshave.

Mbajmë takime të rregullta me komunitetin dhe raportohet për situatë të qetë dhe ka kënaqshmëri dhe besueshmëri të tyre karshi Policisë së Kosovës dhe mund të them se rezultatet tona janë krahas bashkëpunimit të mirë me qytetarët në përgjithësi.

Sa i përket imlementimit të Strategjisë "Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm që shpie në radikalizim", neve mbajmë kontakte të vazhdueshme me BIK-un dhe akterët tjerë përfshirës në këtë Strategji ku kemi nje bashkëpunim shumë të mirë .

Mbajmë tryeza që i kontribuojnë këtij fenomeni që fatkeqësisht as Shteti ynë nuk është imun, por që në komunën e Podujeves nuk kemi ndonjë rast të raportuar me indicie të kësaj dukurie.

Komandanti i Stacionit Policor-Podujevë Kap.Bekim Bislimi gjatë këtij muaji ka mbajtur ligjëratë në Gjimnazin "Aleksander Xhuvani" me temën e kesaj Strategjie.

Përfaqësuesi i KFOR-it, ju falënderoj për ftesën për këtë takim dhe është kënaqësi dhe nderë të prezantoj në këtë Këshill. Sa i përket gjendjes së sigurisë, vlerësohet e qetë dhe e sigurt, nuk ka rrezik për stabilitet. Nga perspektiva jonë Komuna e Podujevës vlerësohet si komuna ndoshta më e sigurtë në aspektin e sigurisë. Kemi takime të rregullta me institucionet relevante, me Policinë e Kosovës-Stacionin Policor në Podujevë (takime javore) ku shkëmbejmë informata dhe vlerësojmë gjendjen e sigurisë.

z. Naim Bajraktari, theksoi, sa i përket gjendjes së sigurisë tani për tani FSK nuk ka ndonjë projekt që ka zhvilluar dhe që ndërlidhet me Komunën tonë, janë disa projekte në proces, të papërfunduara, kështu që me kalimin e kohës kur të përfundojnë do ti paraqesim me kohë.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, lidhur me informatat e paraqitura e hap diskutimin. Nëse nuk ka dikush diçka, atëherë mund të konstatojmë se në bazë të raportimeve të

përfaqësueseve të Stacionit Policor, KFOR-it dhe FSK-së gjendja në Komunën e Podujevës është e qetë, stabile, nuk ka ndonjë problem të theksuar dhe dëshirojmë që kjo gjendje të përmirësohet edhe më tutje. Ne e vlerësojmë shumë punën si të Policisë, KFOR-it dhe të FSK-së, për kontributin e tyre për mbajtjen stabile të gjendjes dhe vlerësimet e përgjithshme janë se Komuna jonë është prej komunave më të qeta, më të sigurta dhe kjo na bënë të gjithëve të ndjehemi mirë. Kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë për implementimin e Planit operativ lokal(2016-18) sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm(2015-2020)

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, sipas Planit të veprimit të KKSB-së, raportues të kësaj pike janë Policia e Kosovës, Drejtoria e Arsimit, Bashkësia Islame. Fillimisht fjalën e ka znj. Antigona Çitaku Dibrani përfaqësuese e Policisë.

znj. Antigona Çitaku-Dibrani, sa i përket kësaj teme Policia e Kosovës në bashkëpunim me akterët tjerë është në implementim të kësaj Strategjie. Kemi zyrtarë të inteligjencës të cilët mbledhin informata që kanë të bëjnë pikërisht me këtë Strategji, po ashtu kemi takime të rregullta me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe akterët tjerë. Paralelisht kësaj në kuadër të kësaj Strategjie Komandanti i Stacionit Policor javën e kaluar ka pas ligjërata në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Gjinnazin “Aleksandër Xhuvani”, ku është përfshirë personeli arsimor dhe nxënës të shkollave të mesme, ligjëratë e cila i kontribuon parandalimit të kësaj dukurie. Mbahen takime të rregullta, ligjërata, tryeza të rumbullakëta që i kontribuojnë implementimit të kësaj Strategjie. Komuna e Podujevës është një ndër komunat e qeta sa i përket këtij fenomeni që fatkeqësisht edhe ne si shtet nuk jemi imun. Neve si komunë fatmirësisht qëndrojmë stabil, nuk kemi ndonjë rast të raportuar, por megjithatë vazhdojmë të punojmë në implementimin e kësaj. Edhe pse nuk kemi raste, t’i kontribuojmë komunitetit në mënyrë që të jet i njoftuar me pasojat dhe ato që e presin në rast se ka indicje apo indikacioneve të përfshirjes në fenomenet negative. Nuk kam diçka për të raportuar, qëndrojmë mirë në këtë aspekt.

z. Agim Blakqori, në kuadër të aktiviteteve për implementimin e Planit operativ për parandalimin e ekstremizmit Drejtoria e Arsimit – DA në takimet e rregullta që mbajmë me drejtorë të shkollave e trajton këtë temë dhe jep hapësirë të mjaftueshme në mënyrë që këto informata të përcillen në organet udhëheqëse profesionale të shkollave në funksion të ndikimit të ngritjes së vetëdijes dhe parandalimin e këtyre dukurive. Sipas vlerësimit në Komunën tonë qëndrojmë mirë në këtë aspekt, mirëpo megjithatë në kuadër të institucioneve edukative organizojmë edhe ligjërata të ndryshme edhe me partnerët tjerë çoftë Policinë dhe organizata të ndryshme joqeveritare me qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve për rrezikun që mund të paraqesin këto fenomene dhe shkaktarët që mund të vijnë deri te kjo. DA ka organizuar debate edhe me USAID-in, Policinë, KKSB, sikurse e përmendi përfaqësuesja e Policisë dy ligjërata të mbajtuara në shkollat e mesme ku pikërisht është trajtuar kjo temë, gjithashtu në muajin mars të këtij viti përfaqësuesit e dy shkollave të mesme të Komunës së Podujevës me përfaqësues të DA dhe drejtorë të shkollave kanë marrë pjesë në një takim në Gjakovë, të organizuar nga USAID-i dhe kanë trajtuar këtë temë. Javën e kaluar gjithashtu është organizuar një takim me Policinë e Kosovës ku me theks të veçantë është trajtuar tema e cekur me Këshillin e prindërve në nivel komunal. Pra janë disa aktivitete të ndërmarra në funksion të parandalimit të kësaj dukurie.

z.Osman Kurtolli, sa i përket kësaj teme mendoj që duhet vazhduar rruga dhe koordinimi me institucionet e arsimit dhe Policinë, bashkëpunim i cili ka qenë shumë në

nivel. Ndikimi jonë ka qenë jashtëzakonisht i madh e që edhe në të ardhmen do të punojmë në këtë drejtim. Për fat të mirë nuk ka ndonjë rast që mund ta veçojmë, por ju falënderoj të gjithëve që jeni angazhuar. Shpresoj që edhe në të ardhmen duke ju falënderuar këtij bashkëpunimi nuk do të kemi raste të tilla. Ne kemi marrë pjesë në të gjitha ato takime që u theksuan. Sikurse e dini ne e kemi obligim edhe fetar për edukimin e të rinjëve në mënyrën më të mirë, kur është fjala për te substancat narkotike, alkooli dhe për dukuritë tjera negative.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, ju falënderoj për informatat e paraqitura, unë e vlerësoj shumë angazhimin e Juaj në këtë fushë të ndieshme për shoqërinë tonë, për shtetin në përgjithësi dhe inkuarajoj të gjithë faktorët që ky bashkëpunim i mirë të vazhdoj, sepse e vetmja mundësi është që të gjithë ne të jemi unik, të koordinuar në këtë aspekt dhe sukcesi sigurisht nuk mungon sepse e përsëris është diçka shumë e ndjeshme që kërkon veprime të koordinuara, të matura, me sens, sepse për ndryshe nuk mund të ketë sukses. Ju falënderoj edhe njëherë të gjithëve. Kalojmë në pikën e fundit.

4. Të ndryshme

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, a ka dikush diçka në këtë pikë, për të ngritur ndonjë çështje apo të propozojë ndonjë temë për mbledhjen e radhës. Nëse nuk keni diçka unë e përmbyll takimin dhe ju falënderoj për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0089226/18
Podujevë, 29 tetor 2018**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**